



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 31

Datë: 03. 07. 2020. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.29/2020.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Mitrovicën e Veriut.

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Planit të punës të KQZ-së për vitin 2020.

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E hapi këtë mbledhje, a ka vërejtje në rendin e ditës ?

Sami Kurteshi: Në të ndryshme, do t'ishte mirë të diskutojmë për planin strategjik! Është mbajtur një mbledhje, dhe se kemi krye diskutimin... Nuk e di çfarë vendimi keni marrë...

Valdete Daka: Mirë, e diskutojmë në të ndryshme...

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin nr.29/2020 nga mbledhja e KQZ-së.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

1.Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Mitrovicën e Veriut.

Arianit Elshani: Këshilli për Çështje Ligjore, ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Mitrovicën e Veriut, dhe pasi që kërkesa ka kaluar të gjithë filtrat e duhur ligjor, është rekomanduar që të miratohet në KQZ.

Valdete Daka: Kush është për që znj. Naxhie Xhema, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme të kuvendit, znj. Gonxhe Çausi.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

2. Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Planit të punës të KQZ-së për vitin 2020.

Alim Rama: Para jush e kemi planin e punës së KQZ-së të amendamentuar me disa ndryshime. Para se me dhënë mendimin e këshillit, unë gjykoj se shtyrja e disa aktiviteteve është për shkak të zgjedhjeve në Podujevë të cilat nuk janë mbajtur, ndonëse përgatitjet janë bërë deri më 15 mars. Zgjedhjet në Podujevë, nuk duhet të jenë arsye për shtyrje të aktiviteteve sepse, plani i punës është bërë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Unë, tha z. Rama, pres prej kryeshefit që stafi i cili nuk kryen aktivitetet e veta në mënyrë efektive, kjo të përfshihet në vlerësim sepse, këto aktivitete janë përfshirë nga secili departament, nga vetë Sekretariati. Edhe pse ne se kemi marrë planin, kjo na tregon se disa aktivitete nuk janë kryer. Mendoj se Sekretariati me pas ma shumë profesionalizëm, për shembull: asnjë aktivitet në QNR nuk është kryer, disa nuk kanë filluar !

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurive jo financiare të KQZ...? Kjo është vërejte edhe e Auditorit Gjeneral, si dhe aktivitetet e tjera, duhet të kryhen. Pra, disa punë që nuk kanë të bëjnë me pandeminë, po vazhdojnë të mos kryhen. Por, pavarësisht, ne duhet ta miratojmë planin...

Eshref Vishi: E di që ky plan është prezantuar në KOZ, është shqyrtuar dhe rekomanduar që të miratohet. Mirëpo, kisha dashur që Kryeshefi ta bëjë një prezantim lidhur me aktivitetet që duhet të stopohen për shkak të rrethanave që nuk ka mundësi të përmbushen, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë se çfarë kërkon Sekretariati në k'te rast...

Në kërkesën e anëtarit, z. Eshref Vishi, kryeshefi, z. Ylli, u përgjigj në hollësi duke veçuar aktivitetet që janë paraparë të hiqen, ato aktivitete që janë paraparë të shkurtohen-afatizohen për shkak të rrethanave tashmë të njohura...

Në shqyrtim të rishikimit të planit të punës për vitin 2020, diskutuan edhe: Alim Rama, Arianit Elshani, Yll Buleshkaç (kryeshef u.d.), Valdete Daka, Eshref Vishi dhe Ibrahim Selmanaj.

Valdete Daka: Meqë, u shteren diskutimet dhe, u dhanë edhe vërejtjet e caktuara, kush është për që të miratohet ky rekomandim i KOZ –it ?

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për, e miratuan Planin e Rishikuar të punës të KQZ-së për vitin 2020.

3. Të ndryshme.

Sami Kurteshi: Në mbledhjen e kaluar gjerë e gjatë diskutuam lidhur me planin, më saktë grupin punues. Unë, kam shikuar në rregullore dhe në ligj, se a mund të ketë grup punues, pra a mundet që KQZ të formoj grupe punuese...Unë, nuk kam gjet as vendime...

Valdete Daka: Po, mundet. Rregullorja, thotë se KQZ formon grupe punuese ad hok! Këshillat ad hok sipas nenit 21 të rregullores, mund të formohen nga anëtarët e KQZ, Sekretariati e në rast nevojë edhe nga ekspertët e jashtëm...

Sami Kurteshi: Po, mirë, por rregulloret, vendimet etj., askund nuk kërkojnë që grupet, këshillat mund të shkelin proporcionalitetin e pjesëmarrjes së grupeve politike! Çka po dua të them ? Plani strategjik është dokument i institucionit ku mund të angazhohen gjithë anëtarët...

Është bërë përpjekje që njëri nga ne të përjashtohet. Kjo, nuk është në rregull ! KQZ ka nevojat e veta, Sekretariati. Mendoj se, unë dhe Alimi jemi të interesuar të marrim pjesë në punën për planin strategjik. Alimi, është pjesë, se dimë se s'i është votuar, por ai nuk ka marrë pjesë...!

Valdete Daka: Po, kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar, dhe në fund jemi dakorduar që grupi të ketë 7+7...! Ju s'jeni dakorduar. Anëtarët e KQZ-së, kanë votuar dhe janë pajtuar për formimin e grupit. Ju, s'keni votuar, sepse jeni larguar nga mbledhja. Por, grupi punues është formuar, ka përfaqësuar...Unë, s'jam pjesë e grupit...Por, grupi ka kredibilitet, anëtarët e KQZ-së me shumicë votash e kanë votuar...

Anëtarët nga subjektit politik Lëvizja “Vetëvendosje!”, nuk u pajtuan me qëndrimet e KQZ-së rreth formimit të grupit.

Alim Rama, nuk u pajtua as me faktin që është propozuar si anëtarë i grupit, dhe është votuar si anëtar i grupit...!

Në debat, diskutuan dhe shprehën mendimet dhe vlerësimet e tyre, si dhe dhanë shpjegime, vërejtje, kundërshtime etj., rreth fokusit të çështjes në debat: Arianit Elshani, Valdete Daka, Sami Kurteshi.

Pas debatit të kësaj pike, kryetarja Valdete Daka, foli rreth mundësisë së pjesëmarrjes së KQZ-së në Zgjedhjeve Parlamentare që mbahen më 15 korrik, 2020 në Maqedoni. Ajo kërkoi nga anëtarët e KQZ-së që, nëse ka interesim për pjesëmarrje të veprohet shpejt !

Anëtarët e KQZ-së, rreth kësaj, propozuan që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen paraprake dhe të vendoset për pjesëmarrje të KQZ-së në këto zgjedhje.